

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



PUNIMI I DIPLOMËS – MASTER

TEMA:

**NDIKIMI I MASËS TRUPORE NË EKZEKUTIMIN E DETYRAVE
MOTORIKE SPECIFIKE NË FUTBOLL**

MENTORI:
Dr. Sc. Bylbyl Sokoli

KANDIDATI:
Armend Kastrati

Prishtinë, 2016

“Futbolli nuk e ndërton karakterin, futbolli e zbulon karakterin e futbollistit”

Marv Levy (1925)



PËRMBAJTA

1. HYRJE	4
2. HULUMTIMET E DERITANISHME	8
3. QËLLIMI I HULUMTIMIT	12
4. HIPOTEZAT THEMELORE	13
5. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	14
5.1 <i>MOSTRA E ENTITETIT</i>	14
5.2 <i>MOSTRA E NDRYSHOREVE</i>	14
5.2.1. <i>NDYSHORET MORFOLOGJIKE</i>	14
5.2.2. <i>NDYSHORET SPECIFIKE-MOTORIKE</i>	14
5.3 <i>PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE</i>	15
5.3.1 <i>PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE ANTROPOMETRIKE</i>	15
5.3.2 <i>Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike specifike</i>	20
5.4. <i>METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE</i>	23
6. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI	24
6.1 PARAMETRAT THEMELORË STATISTIKORË	24
6.1.1 <i>Parametrat themelorë statistikorë të masës trupore te futbollistët e rinj</i>	24
5.1.2 <i>Parametrat themelorë statistikorë të ndryshoreve motorike specifike te futbollistët e rinj</i>	30
6.2. MATRICA E INTERKORELACIONIT	34
6.2.1 <i>Koeficientët e interkorelacionit të ndryshoreve të masës trupore te futbollistët e rinj</i> 34	
6.2.1. <i>Koeficientët e interkorelacionit të ndryshoreve të masës trupore te futbollistët e rinj</i> 36	
6.3 STRUKTURA E HAPËSIRËS MORFOLOGJIKE DHE MOTORIKE SPECIFIKE TE FUTBOLLISTËT E RINJ	38
6.4 <i>ANALIZA REGRESIVE E PARAMETRAVE ANTROPOMETRIKË DHE MOTORIKË SI DHE SPECIFIKË- MOTORIKË</i>	42
6.5 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE	48
7.PËRFUNDIMI	49
8. DOMETHËNIA TEORIKE DHE PRAKTIKE E HULUMTIMIT	51
9. LITERATURA	52

1. HYRJE

Futboli si sport numërohet në grupin e sporteve kolektive, kurse sipas lëvizjeve merr pjesë në grupin e sporteve shumë strukturale të aktiviteteve komplekse, i cili dallohet me lëvizje ciklike dhe aciklike. Është sporti më i popullarizuar në botë, kjo del nga prania, dinamika, emocionaliteti dhe atraktiviteti si dhe shumë lëvizje të përbëra tekniko – taktike.

Gjatë lojës numri më i madh i aftësive motorike në proceset e aktiviteteve komplekse kineziologjike, në rastin konkret në lojën e futbollit, e sidomos gjatë lojës, më së tepërmi varen nga procesi i pranimit, bartjes, mbajtjes dhe përpunimit si dhe përcjelljes me rrugë referente deri te efektorët. Lidhmëria e këtyre elementeve si dhe elementeve tjera antropologjike kërkon nga njeriu që ai të trajtohet si sistem kibernetik.

Që të mund të vlerësohet dhe matet ndonjë aksion i njeriut në hapësirën motorike dhe lidhmërinë e saj me karakteristikat tjera antropologjike është e domosdoshme që këtë strukturë ta identifikojmë.

Është e natyrës që variablat motorike së bashku me aftësitë teknike dhe karakteristika e elementeve taktike si dhe veçoritë konative si dhe ato sociale tek futbollistët duhet të jenë në ndonjë korelacion të caktuar. Niveli dhe vlerat e këtyre raporteve dhe lidhjeve gjerë më tani nuk janë hulumtuar në nivelin e kënaqshëm.

Gjatë aktiviteteve garuese përgatitja kondicionale, teknike, taktike si dhe fushat tjera të përgatitjes së futbollistëve paraqesin tërësinë e ndërlikuar dhe integrale dhe asnjëherë nuk shprehen ndarasi. Çdo drejtim ose të gjitha drejtimet e përmendura të përgatitjes sportive në një masë varen nga niveli dhe struktura e drejtimeve tjera të përgatitjes së sportistëve, dhe në këtë mënyrë së bashku ndikojnë në arritjen e rezultateve maksimale kulminante në lojën e futbollit. Kështu për shembull, përgatitja teknike e sportistëve në sportin e futbollit në masë të madhe varet nga shkalla, aftësitë funksionale dhe motorike. Me fjalë të tjera është e pamundur që futbollistin në mënyrë kualitative ta përgatisim në pikëpamje teknike nëse ai nuk posedon aftësi motorike të cilat janë të domosdoshme për realizimin e elementeve teknike të theksuara gjatë lojës, siç janë për shembull, forca, shpejtësia, koordinacioni, fleksibiliteti, qëndrueshmëria e të tjera. Në anën tjetër vetëm përgatitja e mirë teknike i mundëson futbollistit t'i shprehë plotësisht këto aftësi kondicionale në stërvitje dhe lojë. Njëkohësisht, niveli dhe struktura e qëndrueshmërisë specifike është e lidhur ngusht me realizimin ekonomik të teknikës, me zhvillimin e cilësive specifike psikologjike të futbollistëve, siç janë: toleranca e ngarkesës dhe

lodhjes dhe aftësia e realizimit të detyrave taktike, të thjeshta dhe të ndërlikuara, në kushtet e lojës.

Efikasiteti i zgjedhjes së teknikave të mësuara është e kushtëzuar me aftësitë e caktuara kondicionale dhe në anën tjetër me aftësitë e futbollistit për pranimin, përpunimin dhe shfrytëzimin e informacioneve taktike, vendosmërinë e tij dhe shpejtësisë së gjetjes së zgjidhjeve në problemet taktike të cilat lajmërohen në lojë. Përgatitja integrale mundëson lidhshmërinë e të gjitha aftësive, njohurive dhe cilësive gjatë lojës. Harmonizimi i të gjitha elementeve kondicionale, teknike, taktike dhe përgatitjes psikologjike paraqesin pjesën më të rëndësishme të adaptimit sportiv për pjesëmarrje të suksesshme dhe zgjedhjen e problemeve tekniko-taktike gjatë lojës. Nuk guxon të ndodhë që aftësitë, cilësitë dhe njohuritë të cilat kanë funksione në ndonjë segment të ndarë të përgatitjes të mos lajmërohen në aktivitetet garuese, respektivisht, që të mos jenë të integruara në të. Mënyra sintetike, respektivisht, situacionale e stërvitjes gati gjatë stërvitjes në perudhën përgatitore bashkon disa faktorë të përgatitjes në efikasitetin e përbashkët garues. Për këtë arsye kjo mënyrë e stërvitjes është më e mira për përsosjen integrale të sportistit brenda sistemit të sporteve komplekse polistrukturale. Lidhshmëria e përgatitjeve të llojeve të ndryshme është e kushtëzuar me qëndrimin specifik të modelimit të procedurave metodike dhe programimit të përgatitjes kondicionale, taktike dhe teknike në ciklin shumëvjeçar dhe njëvjeçar të stërvitjes në futboll.

Aftësitë motorike dhe funksionale janë parakushte të domosdoshme për çdo lloj të lëvizjes së njeriut e për këtë edhe për çdo aktivitet kineziologjik ose aktivitet sportiv. Kohëgjatësia, intensiteti, dhe numri i përsëritjeve i strukturave të ndryshme lëvizore, (elementet tekniko-taktike) përcaktojnë rëndësinë e disa aftësive kondicionale. Është e njohur që sa më i ndërlikuar të jetë aktiviteti sportiv, sipas strukturës së lëvizjes, tek ajo paraqitet numër më i madh i aftësive të ndryshme motorike dhe funksionale.

Në harmoni me rregullat e lojës në futboll, shënimi i golit ose goli është i vetmi element me të cilin me përgjegjësi jepet vlera nominale numerike me të cilën definohet angazhimi kumulativ i të dy ekipeve. Secila ndeshje është manifestim specifik i të gjitha aftësive, cilsive, njohurive dhe të gjitha karakteristikave tjera të sportistit, por edhe të trajnerit dhe logjistikës përcjellëse. Pikërisht për këtë ballafaqimi i dy kundërshtarëve prodhon zhvillim të ngjajshëm por kurrë të njëjtë, respektivisht rezultat rrjedhës të ndeshjes. Kampionatet botërore, evropiane, liga e kampionëve, apo e UEFA-s, si dhe gara të tjera në të cilat marrin pjesë kombëtares apo ekipet më

të mira, mbahen kryesisht në një periudhë relativisht të shkurtër kohore me një ritëm të lartë garues dhe për këtë rezultatet e analizave të treguesve të efikasitetit situacional mund të interpretohen vetëm në kontekst të treguesve të dedikuar në aso lloje të garave.

Karakteristikat morfologjike (dimensionet) duhet t'i kuptojmë si esencën biologjike dhe fiziologjike e cila gjëron manifestimin e karakteristikave antropometrike sikur që janë: lartësia e trupit, pesha, perimetri i trupit dhe ekstremiteteve, gjatësitë dhe gjerësitë e kockave, trashësia e indit dhjamor e të tjera. Me këto karakteristika definohet rrita dhe zhvillimi i fëmijëve dhe i rinisë, si dhe ndërtimi trupor i tyre (konstitucioni) edhe atë, ashtu që me këto vërtetohet struktura e karakteristikave morfologjike (Bala, 2007).

Ndërtimi trupor (konstitucioni, somatotipi) është karakteristika më e dukshme e njeriut. Tek të rriturit kjo ka lidhje me sjelljet gjatë jetës, profesionin, sëmundjen, aktivitetin sportiv dhe suksesin. Njohuritë dhe studimi i ndërtimit trupor gjatë rritjes dhe zhvillimit mundëson që ta kuptojmë më mirë variacionin e konstitucionit të njeriut.

Përcaktimi dhe definimi i konstitucionit trupor i fëmijëve dhe i të rriturve në futboll është i vështirë të ekzekutohet, sepse ata ende nuk kanë karakteristika stabile referente, sidomos gjinia femërore. Disa metoda kërkojnë karakteristika stabile dhe fikse (p.sh. somotipet e Sheldonit). Zhvillimi dhe rritja e ndryshme e karakteristikave morfologjike dhe indeve (sidomos e indit dhjamor nën lëkuror) shpejt ndryshojnë proporcionet trupore, çka në mënyrë të rëndësishme ndikon në besueshmërinë e definimit të konstitucionit trupor të fëmijët dhe të rriturit.

Ligjshmëritë e rritjes së fëmijëve dhe të rinisë mund të thjeshtësohen dhe të shumohen në tri veçori:

- intensiteti i rritjes i disa organeve nuk është i njëjtë;
- rritja nuk është lineare, por tregon periudha të intensitetit më të shpejtë ose më të ngadaltë;
- organet gjatë rritjes nuk rrisin vetëm masën e tyre por ndryshojnë radhë në strukturën e tyre.

Loja e futbollit kërkon një nivel të caktuar të disa karakteristikave antropologjike ashtu që futbollistët të veprojnë me sukses në situata të ndryshme si gjatë stërvitjeve ashtu edhe gjatë lojës. Ashtu sikurse ekzistojnë specifikat e disa sporteve të cilat karakterizohen nga diversiteti i

strukturës garuese të tyre, ashtu ekziston edhe nevoja e vazhdueshme e hulumtimit teorik dhe kontrollit praktik të këtyre specifikave.

Aftësitë fizike janë tipare të personalitetit që kontribuojnë në ndryshimet në performancën e ekzekutimit të aktiviteteve të caktuara me kusht që të ekzistojë përvoja dhe motivimi (Pajevic, 2003).

Suksesi i sportistit në aktivitetet fizike varet nga tre grupe faktorësh:

- nga ajo çka mund (i referohet aftësive),
- nga ajo çka din (duke iu referuar nivelit të trajnimit dhe të dijes) dhe
- nga ajo çka don (i referohet motivimit, interesit, vlerave), (Vujmilović, 2012).

Ndonjëherë ndikimi dhe kontributi i futbollistëve në të njëjtën lojë është i ndryshëm, madje edhe disa herë më i madh ose më i vogël, çka në masë të madhe mund t'i referohet ndryshimeve në aftësitë apo karakteristikat e tyre antropologjike. Ato definohen si mundësi potenciale të sportistit për të kryer një aktivitet fizik ose të kryejnë detyra të caktuara (Pajevic, 2003, 58). Aftësitë e mundshme janë të njohura si predispozitë, dhe të aktualizuara, si njohuri dhe aftësi për llojin e aktiviteteve të caktuara.

Për të parashikuar një arritje të veçantë të sportistit në lojën e futbollit, është e rëndësishme të njohim faktorët që ndikojnë në zhvillimin e atyre aftësive dhe nivelin e atyre aftësive. Në grupin e parë përfshihen faktorët trashëgues. Dispozitat që janë të bazuara në strukturat e trashëguara apo gjenetike të sistemit nervor, paraqesin përcaktuesit potencial për zhvillimin e aftësive të caktuara.

2. HULUMTIMET E DERITANISHME

Hulumtime në hapësirën antropometrike dhe motorike janë bërë nga hulumtues të huaj dhe vendorë. Këto janë disa nga hulumtimet që ndërlidhen me temën e cila e trajton këtë problematikë në aspektin kronologjik:

Gabrielič, M. (1972) “Disa aftësi psikomotorike situacionale, potenciale dhe aktuale të rëndësishme për suksesin e fëmijëve në lojën e futbollit”. Rezultatet e hulumtimit kanë treguar nivel të kënaqshëm të predikcionit të suksesit në lojë me ndihmën e testeve të aplikuara.

Elesner, M. (1974) në punimin e Magjistraturës ka izoluar dy dimensione antropometrike dhe motorike, në mostrën e futbollistëve të rangut të dytë federativ dhe republikan të Sllovenisë, dimensionet e izoluar antropometrike: Dimensionin Skeletor, Dimensionin Qarkor të ekstremitetve të poshtme, Dimensionet motorike: Forca Eksplozive, izometrike e kofshës dhe e pjesës abdominale, Forca izometrike e shtrirjes dhe mbledhjes së gjunjëve.

Gjinolli, E. (1982), ka publikuar hulumtimin “Ndikimi i programeve të ndryshme të procesit mësimor të edukimit fizik në disa dimensione të statusit psikosomatik të nxënësve të klasës së pestë të shkollës fillore”. Qëllimi kryesor i hulumtimit ka qenë përcaktimi i disa dimensioneve antropometrike dhe motorike të nxënësve të klasëve të pesta, të shkollave fillore të Shkupit dhe Gjilanit, që kanë mundur të paraqiten nën ndikimin e programeve jo të harmonizuara të edukimit fizik në ato shkolla. Mostra e etniteteve ka përfshirë 150 nxënës të Shkupit dhe 150 nga Gjilani. Janë aplikuar 3 teste të hapësirës antropometrike dhe 7 ndryshore të hapësirës motorike. Me qëllim të krahasimit të rezultateve, janë bërë dy matje gjatë vitit shkollor. Me analizën e rezultateve të fituara, në fillim të vitit shkollor 1977/78 dhe në mbarim të vitit shkollor, ndryshimet antropometrike dhe motorike kanë qenë në favor të nxënësve nga Shkupi.

Sokoli, B (2003) ka hulumtuar hapësirën antropometrike, motorike dhe funksionale të 78 futbollistëve të ligës së parë dhe 80 futbollistëve të ligës së dytë të moshës 18-35 vjeçare. Në

bazë të këtij hulumtimi autori vjen në përfundim se treguesit antropometrikë kanë ndikim të caktuar në parashikimin e rezultateve në shumicën e ndryshoreve motorike dhe funksionale andaj parametrat antropometrikë duhet të merren parasysh me rastin e seleksionimit të futbollistëve të rinj.

Visari, G. (2010) në punimin e doktoraturës ka hulumtuar karakteristikat morfologjike te futbollistët e rinj të moshës 14 vjeçare në një mostër prej 50 të testuarve (25 futbollistë të rinj si grup eksperimental dhe 25 të rinj si grup kontrollues), respektivisht dallimin në mes grupit eksperimental dhe kontrollues, ku janë aplikuar 14 variabla antropomotorike.

Kryeziu, B. (2011) në mostrën ku janë përfshirë dy grupe të futbollistëve të rinj ku grupin e parë dhe të dytë e kanë përbërë nga 50 futbollistë juniorë të Superligës dhe 50 futbollistë juniorë të Ligës së parë të Kosovës, futbollistë nga Gjilani, Prishtina, Gjakova, Peja, Suhareka dhe Prizreni, ka pasur për qëllim krahasimin e veçorive antropometrike dhe aftësi motorike në mes futbollistëve juniorë të superligës dhe ligës së parë të Kosovës. Janë aplikuar 9 ndryshore antropometrike, 5 ndryshore motorike dhe një situacionale. Për gjitha grupet e sistemit të variablave janë llogaritur parametrat themelorë statistikorë dhe të shpërndarjes për secilën variabël, si dhe masat e asimetrisë dhe të shpërndarjes normale, dhe analiza diskriminative, T-testi. Rezultatet e punimit tregojnë se procesi stërvitor i organizuar mirë është njëri nga faktorët kryesor të suksesit në lojën e futbollit. Gjithashtu stërvitja e planifikuar drejt dhe e udhëhequr mirë ndikon pozitivisht në zhvillimin dhe transformimin pozitiv dhe të përgjithshëm të trupit në aspektin e zhvillimit morfologjik, motorik dhe specifiko-motorik çka u vërtetua me ndryshimet e ndodhura te grupi i futbollistëve juniorë të Superligës së Kosovës.

Hysaj, A. (2012) Në punimin e tij “Analiza e parametrave antropometrikë dhe motorikë te lojtarët e grupmoshave 14-16 vjeçarë të regjionit të Pejës në futboll” ka pasur për qëllim vërtetimin e faktorëve morfologjikë dhe motorikë si dhe ndikimit të këtyre karakteristikave antropometrike dhe motorike te futbollistët e rinj. Për realizimin e qëllimit është përfshirë mostra e entiteteve e cila ka qenë e selektuar, në të cilën janë përfshirë 6 klube me nga 15 futbollistë. Gjithsej në hulumtim janë përfshirë 90 futbollistë të grupomoshës 14-16. Rezultatet e fituara nga përpunimi i tyre tregojnë se realizimi i detyrave specifike motorike nuk varet vetëm nga parametrat antropometrikë dhe motorikë por edhe nga ata emocionalë të cilët në shumicën e hulumtimeve anashkalohen si dhe nga faktorët tjerë antropologjikë të cilët nuk janë përfshirë në

këtë hulumtim me këto moshë. Autori thekson se njohja e strukturës së disa dimensioneve të statusit psikosomatik në sporte të ndryshme e në veçanti në lojën e futbollit, me këtë edhe zhvillimit të tij, paraqet kushtin themelor për udhëheqje të suksesshme të procesit stërvitor.

Halimi, G. (2012) në punimin ku qëllimi kryesor ishte të vërtetohet ndikimi i disa parametrave morfologjikë dhe motorikë në udhëheqjen e topit të futbollistëve të moshës 15 – 16 vjeçarë, në një mostër të popullatës prej 67 futbollistëve dhe 20 variabla të aplikuara edhe atë: 8 ndryshore për vlerësimin e statusit morfologjik, 8 teste për vlerësimin e aftësive baziko-motorike dhe 4 teste specifike motorike, është konstatuar se analiza regresive tek futbollistët tregon se vlera e lidhmërisë ndërmjet grupit të variabla të pavarura prediktore (variabla antropometrike dhe motorike) dhe variabla të varura kriterike (udhëheqje e topit sllalom 20 metra, udhëheqje e topit sllalom 40 metra, udhëheqje e topit drejtvizor 20 metra dhe udhëheqje e topit drejtvizor 40 metra) tregojnë se variablat kriterike të aplikuara në këtë punim nuk varen shumë nga parametrat antropometrikë dhe motorikë. Këto janë vërtetuar më së miri me anë të koeficientit multipël të korelacionit, vlerat e së cilave janë testuar përmes F-testit, dhe nuk kanë treguar se janë të rëndësishëm statistikiisht në nivel prej $p=0,05$. Koeficientët e determinacionit dhe korelacionit multipël tregojnë se në rezultatet e udhëheqjes së topit sllalom 20 metra, udhëheqjes së topit sllalom 40 metra, udhëheqjes së topit drejtvizor 20 metra dhe udhëheqjes së topit drejtvizor 40 metra, nuk kanë ndikim testet antropometrike dhe motorike të aplikuara si variabla prediktore.

Rexhepi, A. (2013) ka hulumtuar ndikimin e karakteristikave dhe aftësive antropologjike në udhëheqjen e topit në lojën e futbollit. Mostra ka përfshirë dy grupe, ku grupin e parë (GF) e kanë përbërë 45 futbollistë të rinj të gjinisë mashkullore të moshës 14 vjeçarë (± 6 muaj), të përfshirë në shkollat e futbollit të Komunës së Prishtinës, dhe grupin e dytë (GN) e kanë përbërë 45 nxënës të gjinisë mashkullore të moshës 14 vjeçarë (± 6 muaj), nxënës të Shkollave Filllore të Komunës së Prishtinës që nuk kanë qenë të përfshirë në shkollat e futbollit. Autori ka ardhur në përfundim se është fituar një dallim i rëndësishëm statistikor në mesataret aritmetikore në mes të futbollistëve të rinj dhe nxënësve në të gjitha variablat motorike dhe variablën situacionale. Dallim i rëndësishëm statistikor është fituar në të gjitha ndryshoret motorike dhe situacionale që është si rezultat se futbollistët e rinj përpos orëve të rregullta të edukatës fizike kanë edhe orë shtesë të seancave stërvitore.

Hyseni, A. (2014) në punimin e tij ka hulumtuar ndryshimet në disa karakteristika morfologjike dhe motorike - specifike të ndodhura nën ndikimin e procesit stërvitor të programuar te futbollistët dhe përcaktimi i dallimit në mes këtyre ndryshoreve të hulumtuara të rëndësishme në suksesin e lojës së futbollit, për realizimin e këtij qëllimi janë përfshirë 30 futbollistë (pionerë) të K.F. “Gjilani” dhe 30 jofutbollistë (nxënës) të SH.F.M.U. “Abdullah Tahiri” të moshës 13-15 vjeçare, ka hulumtuar dallimet e disa karakteristikave antropometrike dhe motorike specifike në lojën e futbollit te mosha 13-15 vjeçare. Në këtë hulumtim janë aplikuar gjithsej 15 ndryshore edhe atë: 7 ndryshore për vlerësimin e statutit morfologjik te futbollistët e rinj të përfshirë në shkollat e futbollit dhe 8 ndryshore për vlerësimin e aftësive motorike – specifike. Autori ka ardhur në përfundim se dallimet e fituara që është vërtetuar me anë të t-testit tregon se tretmanet stërvitore të aplikuara te futbollistët e rinj të përzgjedhur për këtë hulumtim kanë ndikuar në ngritjen e atyre aftësive motorike dhe motorike-specifike të cilat janë të domosdoshme në arritjen e rezultateve të mira në lojën e futbollit. Është vërtetuar se në ndryshoret antropometrike nuk mund të ndikohet me tretmane kineziologjike por ato janë nën ndikimin e programeve të caktuara gjenetike. Kjo gjithashtu e ngrit përgjegjësinë që gjatë përzgjedhjes së të rinjve në futboll t’i marrin parasysh edhe këto karakteristika morfologjike.

3. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i çdo ekipe sportive është rezultati sportiv. Ky rezultat nuk mund të ngritet pa një organizim dhe një punë profesionale. Njohuritë mbi zhvillimin morfologjik të sportistëve te sportet ekipore duhet të paraqesin një ndër preokupimet kryesore të trajnerëve dhe stafit drejtues të ekipeve. Nga një pasqyrë e tillë varet edhe niveli shëndetësor, social dhe sportiv i një shoqërie. Problemi i këtij hulumtimi paraqet analizimin e disa parametrave morfologjikë dhe motorikë specifikë të futbollistëve. Problemi i cili trajtohet në këtë punim është i një rëndësie të veçantë, sepse nga rezultatet e fituara mund të vlerësojmë dhe të jepet një pasqyrë reale mbi ndikimin e zhvillimit fizik, sidomos masës trupore në ekzekutimin e detyrave motorike në lojën e futbollit.

Qëllimi i këtij punimi është të përcaktohet raporti dhe ndikimi i masës trupore në ekzekutimin e detyrave motorike specifike në lojën e futbollit.

4. HIPOTEZAT THEMELORE

Në harmoni me qëllimin e hulumtimit parashtrohen këto hipoteza:

H₁ – **Ndryshoret morfologjike** të aplikuara në këtë punim nuk do të kenë shmangie nga distribucioni normal.

H₂ – **Ndryshoret motorike specifike** të aplikuara në këtë punim nuk do të kenë shmangie nga distribucioni normal.

H₃ – **Koficientët e** interkorelacionit ndërmjet ndryshoreve morfologjike dhe motorike specifike në këtë punim do të jenë në një ndërlidhje të rëndësishme statistikore në nivel $p=0.05$.

H₄ – Supozojmë se masa trupore si faktor morfologjik do të ketë ndikim në ekzekutimin e detyrave motorike specifike në lojën e futbollit dhe se ku ndikimi do të jetë statistikisht i rëndësishëm në nivel $p=0.05$

5. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

5.1 MOSTRA E ENTITETIT

Mostra e entiteteve është marrë nga popullata e futbollistëve të rinj të klubit KF. "Feronikeli" të Komunës së Drenasit. Në hulumtim janë përfshirë 35 futbollistë të moshës 14 – 15 vjeçarë. Gjatë zgjedhjes së mostrës për këtë hulumtim, është marrë në konsideratë madhësia e mostrës, gadimshmëria e udhëheqësit të shkollës së futbollit dhe trajnerëve që punojnë në këtë shkollë të futbollit dhe që na mundësojnë kushte për realizimin e këtij punimi me karakter hulumtues.

5.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE

Në këtë hulumtim janë aplikuar gjithsej 8 ndryshore edhe atë: 5 ndryshore për vlerësimin e karakteristikave morfologjike dhe 3 teste specifike – motorike.

4.2.1. Ndryshoret morfologjike

1. Pesha e trupit.....APESHA
2. Perimetri i gjoksit.....APEGJO
3. Perimetri i krahut.....APEKRA
4. Perimetri i kofshës.....APEKOF
5. Perimetri i kërciritAPEKRC

4.2.2. Ndryshoret specifike-motorike

1. Udhëheqja e topit sllallom 20mMUST20
2. Udhëheqja e topit drejtvizor 40mMUDT40
3. Goditja e topit në portë nga 16 metra.....MGTP16

5.3 PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE

5.3.1 Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike

Ndryshoret antropometrike janë matur sipas mënyrës si vijon:

1. Pesha e trupit (APESHA) – matet me peshore decimale me saktësi deri në 0.1 kg. Peshorja vendoset në sipërfaqe të rrafshët. I testuari vendoset në mes të peshores duke marrë pozicion të drejtë. Gjatë matjes janë të veshur me veshje sportive (vetëm në brekë) dhe pas së cilës matje peshorja kthehet në zero (0).

Foto 1. Pesha e trupit (APESHA)



2. Perimetri i gjoksit (APEGJO) – është matur me trakën matëse plastike. Para matjes i testuari është i zbathur, në brekë dhe qëndron në drejtpëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Traka matëse mbështjelllet rreth gjoksit në një pozitë horizontale ndaj boshtit të trupit, duke kaluar horizontalisht nëpër pikat e lidhjes së brinjëve 3. dhe 4. për kockën e gjoksit. Rezultati i matjes lexohet atëherë kur kafazi i krahorrit është në pozitë mesatare (në fund të ekspiriumit normal, respektivisht, në pauzë ndërmjet inspirimit dhe ekspirimit). Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 2. Perimetri i gjoksit (APEGJO)



3. Perimetri i krahut (APEKRA) – është matur me trakën matëse prej plastike. Para matjes i testuari është i zbathur dhe në brekë dhe qëndron në drejtpëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Traka matëse mbështjellët rreth krahut të majtë (pjesës më të trashë) në boshtin e tij, në nivel i cili i përgjigjet mesit ndërmjet akromionit dhe olekranonit. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 3. Perimetri i krahut (APEKRA)



4. Perimetri i kofshës (APEKOF) - është matur me shirit milimetrik. I maturi qëndron në këmbë me gjymtyrë të poshtme paksa të larguara. Shiriti vendoset në të tretën e sipërme të kofshës (gjerësia më e madhe). Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

Fig. 4. Perimetri i kofshës – APERKO



5. **Perimetri i nëngjurit në drejtqëndrim - kërcirit (APEKRC)** – (në drejtqëndrim) është matur me shiritin matës gjysmë plastik. Para matjes i testuari është i zbathur dhe në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim. Traka matëse mbështjellët rreth pjesës së nëngjurit të majtë (pjesës më të trashë) në boshtin e tij në nivel i cili i përgjigjet mesit ndërmjet zogut të këmbës dhe pjesës së epërme të tibies. Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1 cm.

Foto 5. Perimetri i nëngjurit (kërcirit) në drejtqëndrim – APERKC



5.3.2 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike specifike

Ndryshoret motorike specifike janë matur sipas mënyrës si vijon:

1. Udhëheqja e topit sllallom 20m – MUST20

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek, topi i futbollit, pengesa plastike.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron në pozitë të drejtë para vijës startuese para së cilës qëndron topi.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari me shpejtësi maksimale fillon të udhëheqë topin në gjatësinë e shtegut prej 20m nëpër pengesa.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi e deri në momentin kur i testuari kalon me trug vijën e paramenduar me vijën e cakut. Koha matet në saktësi 1/10 sec.

Udhëzime për të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. Të testuarit udhëzohen që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojnë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

Foto 6. Udhëheqja e topit sllallom – MUST20



2. Udhëheqja e topit drejtvizor 40m – MUDT40

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek, topi i futbollit.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron në pozitë të drejtë para vijës startuese para së cilës qëndron topi.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari me shpejtësi maksimale fillon të udhëheqë topin në gjatësinë e shtegut 40m.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi e deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut. Koha matet në saktësi 1/10 sec.

Udhëzime për të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. Të testuarit udhëzohen që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojnë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

Foto 7. Udhëheqja e topit drejtvizor – MUDT40



3. Goditja e topit në portë nga 16 metra – MGTP16

Instrumentet: Topi i futbollit, porta katrore 1x1m.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron në pozitë të drejtë para vijës për goditjen e topit në drejtim të portës para së cilës qëndron topi.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari ekzekuton pesë goditje në drejtim të portës e cila është katrore 1x1m, nga largësia prej 16.

Vlerësimi: Maten golat e shënuara nga ekzekutimi i pesë goditjeve nga momenti i dhënies së sinjalit nga matësi e deri në momentin kur i testuari i ekzekuton pesë goditje.

Udhëzime për të testuarit: Në rast të shënimeve të dyshimta, jo të rregullta, goditja përsëritet.

Foto 8. Goditja e topit në portë nga 16 metra – MGTP16MG



5.4. METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE

Në bazë të qëllimit dhe hipotezave të parashtruara, janë aplikuar metodat e përpunimit të rezultateve të cilat mundësojnë sigurimin e informatave të mjaftueshme për realizimin e qëllimit.

Për të dy grupet e sistemit të variablave janë llogaritur parametrat themelorë statistikorë dhe të shpërndarjes për secilën variabël, si dhe masat e asimetrisë dhe të shpërndarjes normale.

- Vlerat minimale dhe maksimale (**R.min-R.maks**)
- Mesatarja aritmetikore (**Ma**)
- Devijimi standard (**Ds**)
- Parametrat e asimetrisë (**SKEW** dhe **KURT**)
- Koeficienti i variacionit (KV)
- Testi i Kolmogorovit dhe Smirnovit (KS)
- Testi i Shapiro-Wilkut (SHW)

Raportet e ndërlidhjeve ndërmjet variablave në hapësirën manifeste, si dhe korrelacionet ndërmjet sistemit të variablave.

Për vërtetimin e strukturës së dimensioneve antropometrike është aplikuar **Analiza faktoriale**. Numri i rëndësishëm i komponentëve kryesorë është përcaktuar me ndihmën e GK – kriterit (Guttmanit dhe Kaiserit). Ky kriterium bazohet në atë se është i rëndësishëm çdo komponent kryesor, rrënja karakteristike e së cilës është më e madhe ose e barabartë me 1.00 ($\lambda_i \geq 1.0$).

Për verifikimin e ndikimit të faktorëve morfologjikë në detyrat specifike-motorike, është aplikuar **analizën regresive**.

Përpunimi statistikor i të dhënave do të përpunohet në bazë të programit statistikor SPSS, versioni 17.0.

6. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI

Rezultatet e fituara nga hulumtimi i realizuar janë të prezentuara në 17 tabela. Janë bërë analizat themelore statistikore të dy hapësirave të cilat i kemi hulumtuar te futbollistët edhe atë: hapësirën antropometrike dhe baziko-motorike.

6.1 PARAMETRAT THEMELORË STATISTIKORË

6.1.1 Parametrat themelorë statistikorë të masës trupore te futbollistët e rinj


Në tabelën 1 janë paraqitur parametrat themelorë statistikorë të ndryshoreve të masës trupore te futbollistët e rinj. Në tabelën 1 janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet). Gjithashtu është vërtetuar shmangia nga distribucioni normal i rezultateve me anë të testit të Kolmogorovit-Smirnovit dhe Shapiro-Wilkut. Interpretimi i rezultateve do të bëhet së bashku me interpretimin e garfikonave të paraqitura në tabelën 1 dhe grafikonët 1-5.

Tabela 1. Parametrat themelorë statistikorë të ndryshoreve të masës trupore te futbollistët e rinj

	N	Min	Max	Mean	Std. Dev	Skew	Kurt	KO-SM	SH-W
APESHA	35	49.40	93.50	63.9426	8.01730	1.396	4.239	.200*	.004
APEGJO	35	76.90	99.30	86.2571	5.96585	.513	-.497	.200*	.185
APEKRA	35	22.10	32.20	25.8517	2.17817	.901	1.446	.176	.073
APEKOF	35	36.10	61.50	49.8743	5.12705	.079	.971	.200*	.498
APEKRC	35	31.30	43.60	35.0714	2.74082	1.236	1.929	.091	.008


Mesatarja aritmetikore e ndryshores, pesha e trupit (APESHA) te futbollistët e rinj (Tabela 1 dhe Histogrami 1) është 63.94 kg. Rezultati minimal është 49.40 kg, kurse ai maksimal 93.50 kg. Testi i asimetrisë (Skew) është pozitiv (epikurtik) ku shumica e vlerave iu përkasin atyre më të ulëta, sepse mesatarja aritmetikore është më e lartë dhe tregon për një asimetri të theksuar të rezultateve (1.39). Maja e kurbës (Kurt.) është pozitive (4.23) dhe është leptokurtike. Edhe pse distribucioni i rezultateve tregon se rezultatet nuk kanë shmangie nga distribucioni normal që vërtetohet me anë të testit të Kolmogorovit-Smirnovit (0.200), vërtetimi i këtij testi me anë të testit të Shapiro-Wilkut (0.004) tregon se kjo ndryshore ka shmangie nga distribucioni normal.

Histogrami 1. Ndryshorja e peshës së trupit te futbollistët e rinj (APESHA)




Mesatarja aritmetikore e ndryshores, perimetri i gjoksit (APEGJO) te futbollistët e rinj (Tabela 1 dhe Histogrami 2) është 86.25 cm. Rezultati minimal është 76.90 cm, kurse ai maksimal 99.30 cm. Testi i asimetrisë (Skew) është pozitiv (epikurtik) ku shumica e vlerave iu përkasin atyre më të ulëta, sepse mesatarja aritmetikore është më e lartë dhe nuk tregon një asimetri të theksuar të rezultateve (0.513). Maja e kurbës (Kurt.) është negative (-0.49) dhe është platokurtike. Distribucioni i rezultateve tregon se ndryshorja nuk ka shmangie nga distribucioni normal që vërtetohet me anë të testit të Kolmogorovit-Smirnovit (0.200), dhe me anë të testit të Shapiro-Wilkut (0.185).

Histogrami 2. Ndryshorja e perimetrin të gjoksit te futbollistët e rinj (APEGJO)




Mesatarja aritmetikore e ndryshores, perimetri i krahut (APEKRA) te futbollistët e rinj (Tabela 1 dhe Histogrami 3) është 25.85 cm. Rezultati minimal është 22.10 cm, kurse ai maksimal 32.20 cm. Testi i asimetrisë (Skew) është pozitiv (epikurtik), ku shumica e vlerave iu përkasin atyre më të ulëta, sepse mesatarja aritmetikore është më e lartë dhe nuk tregon një asimetri të theksuar të rezultateve (0.513). Maja e kurbës (Kurt.) është pozitive (1.44) dhe është mezokurtike. Distribucioni i rezultateve tregon se ndryshorja nuk ka shmangie nga distribucioni normal që vërtetohet me anë të testit të Kolmogorovit-Smirnovit (0.176), dhe me anë të testit të Shapiro-Wilkut (0.073).

Histogrami 3. Ndryshorja e perimetrit të krahut te futbollistët e rinj (APEKRA)




Mesatarja aritmetikore e ndryshores, perimetri i kofshës (APEKOF) te futbollistët e rinj (Tabela 1 dhe Histogrami 4) është 49.87 cm. Rezultati minimal është 36.10 cm, kurse ai maksimal 61.55 cm. Testi i asimetrisë (Skew) është pozitiv (epikurtik) ku shumica e vlerave iu përkasin atyre më të ulëta, sepse mesatarja aritmetikore është më e lartë dhe nuk tregon një asimetri të theksuar të rezultateve (0.079). Maja e kurbës (Kurt.) është pozitive (0.97) dhe është mezokurtike. Distribucioni i rezultateve tregon se ndryshorja nuk ka shmangie nga distribucioni normal që vërtetohet me anë të testit të Kolmogorovit-Smirnovit (0.200), dhe me anë të testit të Shapiro-Wilkut (0.498).

Histogrami 4. Ndryshorja e perimetrit të kofshës te futbollistët e rinj (APEKOF)



Mesatarja aritmetikore e ndryshores, perimetri i kërcirit (APEKRC) te futbollistët e rinj (Tabela 1 dhe Histogrami 5) është 35.07 cm. Rezultati minimal është 31.30 cm, kurse ai maksimal 43.60 cm. Testi i asimetrisë (Skew) është pozitiv (epikurtik) ku shumica e vlerave iu përkasin atyre më të ulëta, sepse mesatarja aritmetikore është më e lartë dhe tregon një asimetri të theksuar të rezultateve (1.236). Maja e kurbës (Kurt.) është pozitive (1.92) dhe është mezokurtike. Distribucioni i rezultateve tregon se ndryshorja nuk ka shmangie nga distribucioni normal që vërtetohet me anë të testit të Kolmogorovit-Smirnovit (0.091), kurse testi i Shapiro-Wilkut (0.498) tregon se kjo ndryshore ka shmangie nga distribucioni normal.

Histogrami 5. Ndryshorja e perimetrit të kërcirit te futbollistët e rinj (APEKRC)



6.1.2 Parametrat themelorë statistikorë të ndryshoreve motorike specifike te futbollistët e rinj


Në tabelën 2 janë paraqitur parametrat themelorë statistikorë të ndryshoreve motorike specifike te futbollistët e rinj. Në tabelën 2 janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet). Gjithashtu është vërtetuar shmangia nga distribucioni normal i rezultateve me anë të testit të Kolmogorovit-Smirnovit dhe Shapiro-Wilkut. Interpretimi i rezultateve do të bëhet së bashku me interpretimin e garfikonave të paraqitura në tabelën 2 dhe grafikonët 6-8.

Tabela 2. Parametrat themelorë statistikorë të ndryshoreve motorike specifike te futbollistët e rinj

	N	Min	Max	Mean	Std. Dev	Skew	Kurt	KO-SM	SH-W
MUST20	35	16.79	19.95	18.3109	.89981	-.011	-.860	.200*	.289
MUDT40	35	6.00	8.22	6.9694	.44872	.975	2.141	.009	.011
MGTP16	35	2.00	5.00	3.3143	.75815	.679	.450	.000	.000


Mesatarja aritmetikore e ndryshores, udhëheqja e topit sllallom 20m (MUST20) te futbollistët e rinj (Tabela 2 dhe Histogrami 6) është 18.31 sek. Rezultati minimal është 16.79 sek, kurse ai maksimal 19.95 cm. Testi i asimetrisë (Skew) është negativ (hipokurtik) ku shumica e vlerave iu përkasin atyre më të larta, sepse mesatarja aritmetikore është më e ulët dhe nuk tregon një asimetri të theksuar të rezultateve (-0.011). Maja e kurbës (Kurt.) është negative (-0.86) dhe është platokurtike. Distribucioni i rezultateve tregon se ndryshorja nuk ka shmangie nga distribucioni normal që vërtetohet me anë të testit të Kolmogorovit-Smirnovit (0.020) dhe me anë të testit të Shapiro-Wilkut (0.28).

Histogrami 6. Ndryshorja motorike-specifike, udhëheqja e topit sllallom 20m te futbollistët e rinj (MUST20)




Mesatarja aritmetikore e ndryshores, udhëheqja e topit drejtvizor 40m (MUDT40) te futbollistët e rinj (Tabela 2 dhe Histogrami 7) është 6.96 sek. Rezultati minimal është 6.00 sek, kurse ai maksimal 8.22 cm. Testi i asimetrisë (Skew) është pozitiv (epikurtik) ku shumica e vlerave iu përkasin atyre më të larta, sepse mesatarja aritmetikore është më e ulët dhe nuk tregon një asimetri të theksuar të rezultateve (0.975). Maja e kurbës (Kurt.) është pozitive (2.14) dhe është mezokurtike. Distribucioni i rezultateve tregon se ndryshorja ka shmangie nga distribucioni normal që vërtetohet me anë të testit të Kolmogorovit-Smirnovit (0.009), edhe testi i Shapiro-Wilkut (0.011) tregon se kjo ndryshore ka shmangie nga distribucioni normal.

Histogrami 7. Ndryshorja motorike-specifike, udhëheqja e topit drejtvizor 40m te futbollistët e rinj (MUDT40)



Mesatarja aritmetikore e ndryshores, goditja e topit në portë nga 16 metra (MGTP16) te futbollistët e rinj (Tabela 2 dhe Histogrami 7) është 3.31. Rezultati minimal është 2.00, kurse ai maksimal 5.00. Testi i asimetrisë (Skew) është pozitiv (epikurtik) ku shumica e vlerave iu përkasin atyre më të larta, sepse mesatarja aritmetikore është më e ulët dhe nuk tregon një asimetri të theksuar të rezultateve (0.679). Maja e kurbës (Kurt.) është pozitive (0.45) dhe është mezokurtike. Distribucioni i rezultateve tregon se ndryshorja ka shmangie nga distribucioni normal që vërtetohet me anë të testit të Kolmogorovit-Smirnovit (0.000), edhe testi i Shapiro-Wilkut (0.000) tregon se kjo ndryshore ka shmangie nga distribucioni normal.

Histogrami 7. Ndryshorja motorike-specifike, goditja e topit në portë nga 16 metra te futbollistët e rinj (MGTP16)



6.2 MATRICA E INTERKORELACIONIT

6.2.1 Koeficientët e interkorelacionit të ndryshoreve të masës trupore te futbollistët e rinj

Matrica e interkorrelacionit ndërmjet ndryshoreve të masës trupore te futbollistët e rinj është e paraqitur në tabelën 3. Interpretimi i koeficienteve të korrelacionit varet nga numri i të testuarve, respektivisht më preciz, nga shkalla e lirisë.

Kështu që koeficientet statistikisht të rëndësishëm të ndryshoreve me shkallë më të lartë të konkludimit statistikor ($p < 0.01$) janë të shënuara me dy shenja të yllit. Me kriter më të lehtë të konkludimit statistikor ($p < 0.05$), koeficientet e korrelacionit janë shënuar me një shenjë ylli.

